



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/138;
Datë: 28.06.2017.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA		
Komuna Junik-Opština Junik		
QZ/Nr. Prot.	Nr. i faq	Data
2-180/719	1	29.06.2017

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26) dhe Qarkores Buxhetore 2018/01 për Komunat, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 28.06.2017 nxjerrë:

V E N D I M

për

miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2018 - 2020

I. Me këtë vendim miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) në kufijtë preliminar të buxhetit komunal të Komunës së Junikut për periudhën 2018 - 2020 e propozuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2018 -2020.

III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Ministria e Financave;
- Kryetari i Komunës së Junikut;
- Shërbimi i kuvendit të komunës; dhe
- Arkivi i komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ

kryesues





REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNI



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/139;
Datë: 28.06.2017.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA		
Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr. i faq	Data
2-180/4858	1	4.7.2017

Në bazë të nenit 7 paragrafi 7.3 dhe 7.4; nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008) dhe nenit 21 paragrafi 21.1 pika k) të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 28.06.2017, nxjerrë:

V E N D I M

për miratimin e ndryshimit të stemës (logos) së Komunës së Junikut

- I. Me këtë vendim miratohet ndryshimi i stemës (logos) së Komunës së Junikut /në tekstin e mëtejme **stema**/.
 - II. Përshkrimi i stemës (logos) së Komunës së Junikut është si në vijim:
 - II.1. Mburoja e stemës është e llojit Variaz e rrethuar me ngjyra tradicionale;
 - II.2. Brenda hapësirës së mburojës paraqitet ngjyra e kuqe;
 - II.3. Në mes të mburojës paraqitet kulla autoktone junikase si vendi dhe origjina e kullave shqiptare; dhe
 - II.4. Në sfond të stemës paraqitet shqiponja dykrenore.
 - III. Stema (logo) nga pika I. e këtij vendimi do të përdoret në të gjitha dokumentet zyrtare të Komunës së Junikut.
 - IV. Mënyra e përdorimit të stemës (logos) së Komunës së Junikut do të jetë në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Kosovës.
 - V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.
 - VI. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kuvendi i Komunës së Junikut dhe kryetari i Komunës së Junikut.
 - VII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.
- Me këtë vendim njoftohen:
1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
 2. Kryetari i Komunës së Junikut;
 3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
 4. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik Tofaj

kryesues







REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA		
Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr.i faq	Data
2-180/4806	2	3.7.2017



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/ MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/140;
Datë: 28.06.2017 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), nenit 16 paragrafi 9 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1. të Rregullores mbi transparencën, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 28.06.2017 nxjerrë:

V E N D I M

për hapjen e diskutimit publik për projekt Rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2018

- I. Me këtë vendim **hapet diskutimi publik** për projekt Rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2018/në tekstin e mëtejme projekt Rregullorja/.
- II. Projekt Rregullorja nga pika I. e këtij vendimi vihen në dispozicion të publikut për shqyrtim publik dhe komente.
- III. Të gjitha propozimet dhe vërejtjet që paraqiten nga publiku brenda afatit kohor prej 15 ditëve do të përfshihen në raportin e shqyrtimit publik.
- IV. Ekspozimi i projekt Rregullores do të bëhet në zyrën numër 7 të objektit të Komunës së Junikut.
- V. Diskutimi publik i projekt Rregullores zgjat 15 ditë (fillon më: 03.07.2017 dhe përfundon më: 20.07.2017).
- VI. Gjatë kohës së diskutimit publik projekt Rregullorja ekspozohet edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe komente.
- VII. Diskutimi publik i projekt Rregullores organizohet nga Komuna e Junikut respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.
- VIII. Organizatori është i obliguar që të hartojë planin e veprimit dhe organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së diskutimit publik të kësaj projekt Rregulloreje.
- IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.
- X. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ

kryesues

